



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 20 Shorti

Data e shortit: 30.11.2017

Nr. 19 Vendimi

Data e vendimit: 14.05.2018

V E N D I M

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Etleda Çiftja

Valbona Sanxhaktari

Xhensila Pine

Kryesuese

Anëtare

Relatore,

asistuar nga sekretare gjyqësore Znj. Anisa Duka, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Branko Hrvatit, më datë 10.05.2018, ora 11:00 paradite, dhe më datë 14.05.2018, ora 09:30 paradite, në Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Znj. Manjola Xhaxho, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI :

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE :

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, Znj. Xhensila Pine, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi i tij për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi:

VËREN:

RRETHANAT E ÇËSHTJES

Manjola Xhaxho, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b¹ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është subjekt i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e në vijim, referuar si Komisioni), ka hedhur shortin më datë 30.11.2017, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi, nga trupa gjyquese nr. 3.

Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “ILDKPKI”), sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “DSIK”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (këtu e më poshtë referuar si “KLD”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

Me vendimin nr. 1 të trupës gjyquese nr. 3, datë 30.11.2017, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të caktojë me mirëkuptim si kryesuese të trupës për këtë subjekt rivlerësimi Znj. Etleda Çiftja. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

Më datë 25.04.2018, trupa gjyquese, pasi vendosi të përfundojë hetimin kryesisht, me anë të postës elektronike njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

Më datë 10.05.2018 dhe më datë 14.05.2018 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit.

Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”*, trupa gjyquese vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin, Znj. Manjola Xhaxho, mbi të tri kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të figurës dhe atë profesional.

BASHKËPUNIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, SIPAS NENIT 48 TË LIGJIT NR. 84/2016

Gjatë të gjitha fazave të hetimit, trupa gjyquese ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme. Trupa gjyquese konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenin 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, trupa gjyquese kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së, në Deklaratën për Rivlerësimin Kalimtar - Vetting; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisioni nga ILDKPKI-ja; (c) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, (ç) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga KLD-ja, (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenin 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (e) denoncimet nga publiku;

Në referim të dispozitave ligjore kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, siç përcaktohet edhe në Vendimin nr. 2 dhe Vendimin nr. 78, të vitit 2017, të Gjykatës Kushtetuese.

Gjatë hetimit, bazuar në dosjen përkatëse, u ndërmorën hapat si më poshtë:

- U administruan dokumente nga organet publike, bazuar në nenin 50 të ligjit nr. 84/2016.
- U administruan raportet e sjella nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLD-ja .
- U administruan deklaratat, përgjigje dhe shpjegime nga ana e subjektit të rivlerësimit.
- U administruan dëshmi nga dëshmitarët e kërkuar nga vetë subjekti.
- U administrua 1 denoncim nga publiku.
- Nuk u dha mendim me shkrim nga vëzhguesi ndërkombëtar.

I. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur është dorëzuar në ILDKPKI, më datë 20.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ILDKPKI-ja ka dërguar raportin e detajuar lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit, sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka kryer një proces të plotë hetimor administrativ nga Komisioni, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në:

(i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive, deklarimeve të rremë apo konfliktit të interesit, parashikuar nga ligji nr. 84/2016,

nga ku rezultoi se:

Mbi asetet e deklaruara nga subjekti në Deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016:

1. Kursime në “Intesa Sanpaolo Bank” në vlerën 10,730.97 USD (dhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë dollarë e nëntëdhjetë e shtatë cent). Pjesa takuese 100%.

1.1 Burimi i deklaruar i krijimit: Kursimet personale nga të ardhurat e siguruara nga puna.

*Nga hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit rezulton se, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 10.01.2018, të “Intesa Sanpaolo Bank”, janë evidentuar hapja e llogarisë nr. ***, në këtë bankë, në USD, në vitin 2010, e më pas shumë kanë kaluar periodikisht në depozita me afat nga viti 2014 e në vazhdim.*

2. Kursime në “Credins Bank”, në vlerën 411,672.18 (katërqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë. Pjesa takuese 100%.

2.1 Burimi i deklaruar i krijimit: Kursimet personale nga të ardhurat e siguruara nga puna.

*Nga hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit rezulton se, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 24.01.2018, të “Credins Bank”, janë paraqitur gjendjet e llogarive ndër vite të subjektit të rivlerësimit në këtë bankë. Në datën 31.12.2016, shuma në llogarinë e pagës në lek është 399,226 lekë.*

3. Subjekti i rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, deklaron² se jeton në një apartament banimi 2+1, me sip. 95 m², Rruga e *, në pronësi të prindërve, Z. N.Xh. dhe Znj. D.Xh.**

Çmimi i blerjes: 5,656,800 lekë.

3.1 Burimi i deklaruar i krijimit: Të ardhurat e familjes, prindërve dhe vëllait.

3.2 Mënyra e krijimit të pasurisë

3.2.1 Kontrata e sipërmarrjes, datë 28.03.2000, mes sipërmarrësit të shoqërisë “***” dhe porositësit, Znj. Manjola Xhaxho;

3.2.2 Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme, datë 26.12.2000, mes palëve, shitësit shoqëria “***” sh.p.k., dhe blerësit, Znj. Manjola Xhaxho;

3.2.3 Kjo pasuri është dhuruar nga subjekti me kontratë dhurimi datë 01.09.2011, nr. *** rep., *** kol. datë 01.09.2011, mes palëve, dhurues Manjola Xhaxho dhe pranues të dhurimit, N. Xh. dhe D. Xh. (prindërit e subjektit).

Nga provat shkresore të administruara sipas informacionit të marrë nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenin 50 të ligjit nr. 84/2016 dhe përgjigjet e subjektit, rezultoi se:

3.3 Apartamenti me sipërfaqe 95 m² u është dhuruar nga subjekti Manjola Xhaxho dy prindërve të saj, me kontratën e dhurimit të datës 01.09.2011.

3.4 Ky apartament ishte blerë nga subjekti Manjola Xhaxho me kontratën e datës 28.03.2000, nga shoqëria “***” sh.p.k., në shumën 5.656 800 lekë, shumë të cilën e ka likuiduar me këste, duke paraqitur mandate për kryerjen e tyre.

3.5 Referuar kartelës së pasurisë përcjellë me shkresën me nr. *** prot., datë 31.01.2018, të ZVRPP-së Tiranë, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka regjistruar këtë pasuri më datë 10.06.2006, pra pas 6 vitesh nga data e lidhjes së kontratës së shitblerjes. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit aplikimin për regjistrimin e kësaj prone

² Në lidhje me këtë pasuri, subjekti deklaron se ky apartament është blerë në periudhën kur ajo ka qenë studente. Duke qenë se studionte dhe kishte njohuri juridike, familja vlerësoi që ajo të kryente veprimet juridike për blerjen e kësaj pasurie.

në ZVRPP në emrin e saj, bërë në datë 14.02.2002. Ajo sqaroi se është pajisur me certifikatë pronësie, datë 05.12.2009.

3.6 Aktualisht, kjo pasuri është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në bashkëpronësi të prindërve të subjektit, Z. N.Xh dhe Znj. D. Xh, më datë 03.09.2011, të cilat kanë gjithashtu në bashkëpronësi të tyre edhe një apartament me sipërfaqe 63.3 m² në Tiranë.

3.7 Në Deklaratën përpara fillimit të detyrës, në vitin 2003, subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie të ardhurat nga vëllai, kurse në Deklaratën-vetting, në vitin 2017, ka deklaruar si burim të ardhurat e familjes, prindërve dhe vëllait.

3.7.1 Lidhur me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan sqarime mbi burimin e saktë të pasurisë apartament banimi, 2+1, me sip. 95 m², të ndodhur në Krugën e ***.

3.8 Në përgjigje të pyetësorit, subjekti sqaroi se *“Pagesa për blerjen e këtij apartamenti e ka burimin kryesor nga të ardhurat e vëllait, por dhe një pjesë, rreth 10%, nga të ardhurat e prindërve. Sqaroj se, duke qenë se prindërit në atë kohë kanë mbajtur, administruar dhe realizuar kursimet e të ardhurave të familjes – në të cilat pjesa më e madhe e kursimeve vinte prej të ardhurave të vëllait, por dhe një pjesë, rreth 10% e tyre, nga të ardhurat e vetë prindërve, kam bërë në formularin e vetëdeklarimit një deklaram më të detajuar për burimin e të ardhurave të kësaj pasurie”*.

3.9 Referuar listës së noterëve të përcjellë nga Ministria e Drejtësisë, ku subjekti ka kryer veprime noteriale, u vu re se përgjithësisht veprimet e kryera pranë noterëve janë vërtetime të njësisë me origjinalin, prokurë e posaçme, testament përpilimi në zyrë ose vërtetime përkthimi.

3.10 Nga përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, pas adresimit të pyetësorit të parë më datë 15.12.2017, pyetjes së parë nëse ka jetuar në adresën që është shënuar në zyrat e gjendjes civile apo në atë që ka shënuar në vetëdeklarim në shtatë vitet e fundit (respektivisht 2011 - 2017), subjekti informon se ka jetuar në adresën e deklaruar në vetëdeklarim.

Subjekti deklaroi se nuk ka qenë përfutues i ndonjë prej pasurive/llogarive bankare të regjistruara në emrin e ndonjë personi tjetër brenda apo jashtë Shqipërisë; nuk ka përdorur pasuri të regjistruara në emër të dikujt tjetër.

Ka deklaruar se, që prej gushtit 2017, ka llogari bankare në Holandë, ku i kalon çdo muaj pagesa e bursës; deklaroi se nuk ka kryer shpenzime që e tejkalojnë shumën 2 500 euro në shtatë vitet e fundit; nuk ka marrë trajtim mjekësor me kosto mbi vlerën 1000 euro në shtatë vitet e fundit; nuk ka kryer arredime me vlera që e tejkalojnë shumën 2500 euro secila; nuk ka shtëpi të sajën; nuk ka kryer investime në para dixhitale.

3.11 Nga përgjigjet e ardhura nga ZVRPP-ja, deri më datë 27.03.2018, nuk konfirmohet pasuri tjetër e regjistruar në emër të subjektit, Znj. Manjola Xhaxho.

4. Nga verifikimi i deklaratave periodike në dosjen e ILDKPKI-së konstatohet se mungon deklaratata e interesave private për vitin 2006.

Nga hetimi i Komisionit, rezultoi se:

4.1. ILDKPKI-ja, me shkresën kthim-përgjigje, nr. *** prot., datë 06.03.2018, informoi Komisionin se subjekti Manjola Xhaxho nuk rezultoi të ketë dorëzuar deklaratën “Periodike vjetore, 2006”, duke mos përmbushur detyrimin e saj ligjor për të dorëzuar brenda datës 31.03.2007 deklaratën e interesave private 2006, duke konstatuar se për subjektin Manjola Xhaxho: *“Deklarimet e subjektit ndër vite nuk janë të sakta”*.

4.2 ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 08.03.2018, në përgjigje të kërkesës për rishikimin e aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit, Znj. Manjola Xhaxho, informon Komisionin se nuk ka parashikim ligjor për rishikimin e raporteve përfundimtare të dorëzuara nga ILDKPKI-ja.

4.3 Në përgjigje të pyetësorit drejtuar subjektit, në lidhje me mungesën e deklaratimit të vitit 2006, ajo informon më datë 18.03.2018: *“Nga gushti 2006 deri në dhjetor 2007 kam qenë me leje të KLD-së për studime pasuniversitare në Suedi. Kur jam kthyer, në vitin 2008, kam bërë deklaram për të dy vitet, 2006 dhe 2007, duke specifikuar secilin prej tyre”*.

4.4 KLD-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 07.03.2018, ka vënë në dispozicion të Komisionit kërkesën drejtuar KLD-së më datë 08.06.2006 nga subjekti Manjola Xhaxho për shkëputje nga puna për arsye studimi; aprovimin e kryetarit të gjykatës lidhur me këtë kërkesë në atë periudhë; si dhe miratimin e dhënë nga KLD-ja për kryerjen e kualifikimit në periudhën shtator 2006 - janar 2008, me shkresën me nr. *** prot., datë 10.07.2006.

Analizimi i provave nga Komisioni

Mbështetur në nenin 3/1, germa “d”³ dhe në nenin 4⁴ të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, subjekti i rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, me detyrë gjyqtare në atë periudhë, ka pasur detyrimin për deklaramin periodik në ILDKPKI, brenda datës 31 mars të çdo viti, të gjendjes deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare.

Nga verifikimi i deklaratave periodike të ndodhura në dosjen e ILDKPKI-së dhe siç konfirmohet nga ky institucion, me shkresën kthim-përgjigje, nr. *** prot., datë 06.03.2018, subjekti Manjola Xhaxho nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në dispozitat e mësipërme për dorëzimin e deklaratës së interesave private të vitit 2006 brenda datës 31.03.2007, për arsye se, sikundër ajo e provoi, në periudhën në fjalë ka qenë me studime pasuniversitare jashtë vendit me leje të KLD-së dhe kur është kthyer, në vitin 2008, ka bërë deklaramin për të dy vitet, 2006 dhe 2007.

Konkluzioni i Komisionit

³ d) prokuroret, gjyqtarët dhe përmbauesit e të gjitha niveleve;

⁴ Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklaramin dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë:

Sa më sipër, pavarësisht nga raporti i hollësishëm i dërguar nga ILDKPKI-ja, për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit sa më objektiv dhe të paanshëm, është kryer hetim administrativ i pavarur nga ana e trupës gjykuese.

Nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ ka rezultuar se nuk ka dyshime mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe llogaritë e subjektit të rivlerësimit, përfshi edhe personat e lidhur me të. Po kështu, në të gjitha rastet e hetuara përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.

Nën dritën e gjetjeve të mësipërme dhe nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se nuk janë konstatuar elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme, pas verifikimit ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Lidhur me faktet dhe rrethanat e mësipërme, Komisioni administroi nga institucionet dhe vetë subjekti shkresat, si më poshtë:

- Shkresë nr. *** prot., datë 05.01.2018, nga “Raiffeisen Bank”;
- Shkresë nr. *** prot., datë 12.01.2018, nga “Intesa Sanpaolo Bank”;
- Shkresë nr. *** prot., datë 16.01.2018, nga “BKT”;
- Shkresë nr. *** prot., datë 23.01.2018, nga “Union Bank”;
- Shkresë nr. *** prot., datë 24.01.2018, nga “Credins Bank”;
- Shkresë nr. *** prot., datë 31.01.2018, nga ZVRPP Tiranë;
- Shkresë nr. *** prot., datë 23.02.2018, nga ZVRPP Fier;
- Shkresë, datë 20.02.2018, nga noterja E. S. H.;
- Shkresë nr. *** prot., datë 6.03.2018, nga ILDKPKI;
- Shkresë nr. *** prot., datë 12.03.2018, nga ILDKPKI;
- Shkresë nr. *** prot., datë 07.03.2018, nga KLD;
- Shkresë nr. *** prot., datë 09.02.2018, nga KLD.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

Me shkresën nr. *** prot., datë 17.01.2018, drejtuar DSIK-së, është kërkuar rishikimi i raportit për subjektin Manjola Xhaxho dhe nisja e procedurave për deklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.

Në përgjigje të saj, DSIK-ja ka dërguar një raport të rishikuar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, *ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Manjola Nikollaq Xhaxho.*

Rivlerësimi nga Komisioni

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Nga hetimi administrativ nuk rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KRITERIT ETIKO-PROFESIONAL

Sipas informacionit të marrë nga KLD-ja, janë analizuar dokumentet si më poshtë:

- Formulari i vetëdeklarimit;
- 3 dokumente ligjore dhe dokumente të tjera të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Rivlerësimi nga Komisioni

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në:

- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLD-së;
- Informacionin e marrë nga burime të ligjshme;
- Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nga analizimi i sa më sipër rezultoi se:

Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore - Subjekti i rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën administrative, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ajo ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit -ndihmëse ligjore në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Njohuritë e saj ligjore konfirmohen edhe nga angazhimet e saj akademike ndër vite. Karakteristikë e relacioneve është pasqyrim i detajuar i linjave kryesore të arsytimit të vendimit të përdorura nga gjykatat e faktit, duke paraqitur edhe vendimet unifikuese të përdorura

nga gjykatat përkatëse, si dhe qëndrimet e gjykatave lidhur me pretendimet kryesore të palëve, madje në një rast çështjet, të cilat duhet të marrin vëmendjen e Kolegjit të Gjykatës së Lartë, theksohen në dokument me qëllim dallimin e tyre.

Arsyetimi ligjor - 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit janë të shkruara qartë dhe në mënyrë të kuptueshme me strukturë të mirorganizuar, edhe mendimi i ndihmësit ligjor ka organizim më vete në formën e një minivendimi sipas natyrës së çështjeve që duhet të merren në konsideratë në zgjidhjen e çështjes së rekursuar. Në një rast tjetër, mendimi i ndihmësit ligjor nuk ka pika të përbashkëta me vendimin e Gjykatës, por gjyqtari në pakicë, pranë të cilit ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor subjekti i rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, ka dalë me mendim pakice, duke argumentuar mbi bazën e dispozitave ligjore dhe nënligjore kalimtare të zbatueshme në rastin konkret, të cituara në relacionin e ndihmësit ligjor.

Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë - Subjekti i rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, në periudhën e rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 08.10.2013 - 31.12.2013. Për periudhën janar 2014 - dhjetor 2016 ajo ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë kryetarit të Gjykatës së Lartë, mbi bazën e lejes së aprovuar nga KLD-ja, dhe në janar të vitit 2017 është rikthyer për të ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë- Gjyqtarja Manjola Xhaxho ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 06.07.2000 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2003. Pas studimeve, më datë 21.10.2003, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon edhe aktualisht. Në periudhën janar 2014 - dhjetor 2016, me kërkesë të kryetarit të Gjykatës së Lartë, ajo është lejuar nga KLD-ja të shërbejë në detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Në janar 2017, subjekti i rivlerësimit është rikthyer në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe aktualisht, me leje të KLD-së, sërish po ndjek studime pasuniversitare në Holandë. Nga praktika dokumentare e administruar në funksion të procesit të rivlerësimit, nuk ka të dhëna lidhur me etikën në punë, kjo edhe për shkak të natyrës së punës. Referuar aktit të vlerësimit profesional për periudhën janar 2014 - qershor 2016, të nënshkruar nga kryetari i Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ajo ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor, si dhe nga gjyqtarët anëtarë të Kolegjit Administrativ, gjyqtarja Manjola Xhaxho është vlerësuar korrekte në marrëdhënie me kolegjet ndihmës ligjorë, administratën e gjykatës, gjyqtarët dhe kryetarin e Gjykatës së Lartë, si gjatë orarit zyrtar, ashtu edhe jashtë tij. Ajo respekton disiplinën në punë në përputhje me rregulloren e gjykatës dhe normat e etikës. Nuk ka të dhëna të tjera në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë e subjektit në funksion.

Integriteti- Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, dhe nga 5 dokumentet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia- Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 relacionet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho. Asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 relacionet e vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Aftësitë e komunikimit - Në 8 dokumentet ligjore nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta. Ndërsa gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore, i qartë, i plotë dhe i saktë.

Aftësia për të bashkëpunuar - Në asnjë prej relacioneve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e saj me gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor apo me trupën gjyqësore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nuk janë konstatuar vonesa në relatimin e çështjes që të ketë sjellë problematikë në gjykimin e çështjes nga ana e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, kjo edhe për faktin se praktika e punës në këtë gjykatë dhe veprimet e ndihmësit ligjor me dosjet përkatëse nuk evidentohen në regjistra për të matur parametrat e shpejtësisë dhe të sasisë në punë.

Gatishmëria për t'u angazhuar - Subjekti i rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Ajo ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 06.07.2000 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2003. Në vijim, është specializuar me titullin “Master në ligj për të drejtat e njeriut në planin ndërkombëtar”, Lund, Suedi, si dhe stazh 3-mujor pranë fondacionit “Slynn” për sistemin e drejtësisë në Mbretërinë e Bashkuar.

Subjekti ka pjesëmarrje në seminare, trajnime të ndryshme, të kryera brenda dhe jashtë vendit, brenda dhe jashtë periudhës së rivlerësimit 2013-2016.

Vlerësimi i ankesave për subjektin e rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho

Lidhur me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, në zyrën e arkiv/protokollit të KLD-së, disponohen dy ankesa si vijon:

1. Ankesa e shtetasit K. K., e vitit 2009.

Në lidhje me këtë ankesë, rezulton se nga verifikimi i kryer në zbatim të urdhrit të verifikimit, nuk provohen të jenë kryer shkelje të tilla që të përbënin shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtares Manjola Xhaxho, por ajo veprimtari e saj duhet të evidentohet për efekt të vlerësimit të aftësive profesionale si pasojë e gjykimin te afateve të përcaktuara në vendimin e KLD-së, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, meqenëse nga ana e saj nuk janë marrë masat për organizimin e mirë të punës. Seancat gjyqësore të datave 31.03.2009 dhe 15.05.2009 janë shtyrë për mungesë të sekretares gjyqësore. Kjo ankesë është arkivuar.

2. Ankesa e shtetasit J. D., e vitit 2013.

Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është depozituar një ankesë, me dosje denoncimi nr. *** prot., datë 08.01.2018, nga denoncuesi J. D. Ky shtetas denoncon subjektin e rivlerësimit, gjyqtaren Manjola Xhaxho, dhe prokurorin A. D. për aftësitë profesionale, shkelje të etikës profesionale dhe zvarritje në proces. Si më sipër, ankesa e shtetasit J. D. është marrë në trajtim

edhe nga KLD-ja dhe është konkluduar se nuk ka vend për verifikim të mëtejshëm të saj dhe duhet të arkivohet.

Sipas shqyrtimin të denoncimit të shtetasit J. D., ai ankohet ndaj një vendimi gjyqësor të dhënë nga Znj. Manjola Xhaxho, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin e saj ka deklaruar fajtor dhe ka dënuar me 5 vjet burgim djalë e tij, B. D. Ky shtetas ka pretenduar se nga gjykata nuk është aplikuar ulja me 1/3-ën e dënimit, si dhe nuk është marrë parasysh se ky shtetas ka qenë i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale.

Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Manjola Xhaxho është depozituar vetëm ky denoncim, nga shtetasi J. D. Ky denoncim është marrë në trajtim edhe nga trupa gjyqësore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe ka rezultuar se denoncimi ka të bëjë me fakte të cilat zgjidhen në rrugë gjyqësore mbi bazën e apelimit të vendimeve, duke kundërshtuar vendimet e gjykatave më të ulëta të gjykatat më të larta, duke mos qenë objekt i punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Trupa gjyqësore, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk gjeti indice apo elemente që mund të ngrinin dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

NJOFTIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT DHE VËZHGUESIT TË OPERACIONIT NDËRKOMBËTAR TË MONITORIMIT

Trupa gjyqësore, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Branko Hrvatin, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, në seancë dëgjimore në datën 10.05.2018, ora 11:00 paradite, në sallën e Pallatit të Kongreseve, në Tiranë, si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit.

Znj. Manjola Xhaxho mori dijeni dhe u paraqit personalisht në seancat dëgjimore të datës 10.05.2018 dhe 14.05.2018.

Ajo nuk paraqiti prova apo pretendime gjatë kësaj seance, duke kërkuar rikonfirmimin në detyrë.

Trupa gjyqësore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se:

***Së pari:** nuk janë konstatuar elemente të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të sakta dhe në përputhje me ligjin.*

***Së dyti:** nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.*

***Së treti:** nuk gjeti indice apo elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.*

PËR KËTO ARSYE,

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Branko Hrvatin, dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Znj. Manjola Xhaxho, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 14.05.2018.

KRYESUES
Komisionere

Etleda ÇIFTJA

RELATOR
Komisionere

Xhensila PINE

Sekretare gjyqësore

Anisa DUKA

ANËTAR
Komisionere

Valbona SANXHAKTARI